

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 13.3.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, mr. Ivona Mufisheva. Goran Radunoviq, mr. Vladimir Gjorgjieski, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 10-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 8.3.2023.
2. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio në nivel lokal.
3. Propozim për ndërprerjen e procedurës së incuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj operatorit KABELI-NET nga Strumica për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.
5. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 8.3.2023, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z.Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio në nivel lokal. Ai shpjegoi se transmetuesi sipas faturës së lëshuar nga 5 janari 2023 duhej të paguaj 6.844,00 denarë për kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio. Mirëpo, pas pranimit të faturës në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditësh, ai nuk e ka kryer pagesën. Për atë arsye, propozohet që të fillojë procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALLANDOVO SHPK Vallandovë. Ai shpjegoi se shuma është shumë e vogël, por me siguri transmetuesi po përballet me probleme të caktuara.

Këshillii Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALLANDOVO SHPK Vallandovë, nr.08-90 datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20 dhe 77/21).

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr.05-1090/1 datë 10.3.2023 transmetuesi nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, respektivisht nuk ka paguar kompensimin (tarifën) vjetore për leje për transmetim në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin (tarifën) vjetore për leje në pajtim me Faturën e lëshuar (dhënë) nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesë mbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë tregtare Radiodifuzive RADIO VALLANDOVO SHPK Vallandovë, nr.08-90 datë 5.1.2015.

Z.Petrushevski pas votimit tha se transmetuesi duhet të informohet me kohë për iniciimin e procedurës dhe për afatin përfundimtar deri kur duhet të kryhet pagesa.

## **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj SHTR RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar. Shpjegoi se për këtë transmetues në seancën e kaluar, ka filluar procedurë për heqjen e lejes për shkak sepse nuk kishte paguar kompensimin (tarifën) vjetore. Ndërkohë, në të njëjtën ditë derisa mbahej seanca, ai ka kryer pagesën. Por meqënëse procedura tashmë ka filluar, propozohet në pajtim me LSHMAAV e njëjta të ndërpritet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë tregtare Radiodifuzive RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar, nr.08-101 datë 5.1.2015.

Më 8.3.2023 transmetuesi i lartpërmendur ka kryer pagesën në shumë prej 14.116,00 (katërdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) denarë, nga ku kompensimin (tarifën) vjetor për lejen për transmetim në radio e pagoi plotësisht.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në uebfaqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Z.Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj operatorit KABELL-NET nga Strumica për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV. Ai shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt ndaj këtij transmetuesi është konstatuar se ai ka ritransmetuar një shërbim programor të huaj që nuk mbulohet me vërtetimin (çertifikatën) e regjistrimit të dhëna nga Agjencia. Për këtë arsye, në pajtim me Ligjin propozohet t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV dhe detyrohet menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor që nuk është i regjistruar.

Këshilli i Agjencisë pasi shqortoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-1091/1 datë 10.3.2023 dhe njëzëri konkludoi që operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KABELI- NET SHPK Strumicë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 7.11.2022 detyrohet menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KABELI-NET SHPK Strumicë, që sipas notifikacionit (njoftimit) nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfytëzuesit e tij ritransmeton shërbimin programor „Euronews Bugaria“ që nuk mbulohet me vërtetim (çertifikatë) për regjistrim të shërbimit programor e dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediaatike Audio dhe Audiovizuale, që bie në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti (transmetuesi) veprimi sipas masës së shqiptuar.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në uebfaqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

##### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-1099/5**

**21.03.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**